QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

Data 05.02.2020

FTESE PËR SHPREHJE INTERESI PËR EKSPERTIZË

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH), në kuadër të projektit '3C4SME Work Plan of the Context Analysis', per realiziimin e nje studimi ne Bashkinë Fier, **hap thirrjen për Konsulente /Ekspertë si më poshtë.**

Informacion i përgjithshëm rreth QSHPZH

QSHPZH-ja është një organizatë jo fitimprurëse, e themeluar në Janar të vitit 1993, e cila punon për përmirësimin e politikave, legjislacionit, të drejtën për informacion dhe shërbime për cështje që shqetësojnë popullatën dhe zhvillimin e saj, përfshirë shëndetin riprodhues dhe zhvillimin.

*Organizata duke qënë implemetuese e projektit: "*të projektit '3C4SME Work Plan of the Context Analysis'*", i cili zbatohet nga Qendra Shqiptare per Popullsin dhe Zhvillimin ne Bashkine Fier, hap thirrjen për shërbime:*

- Ekspert Drejtues per Studimin (1)

TERMA REFERENCE

1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E KONTRAKTIMIT

Synimi i përgjithshëm i kontraktimit është sigurimi i shërbimeve / Ekspertizës ne kuadër të projektit "**3C4SME Work Plan of the Context Analysis'**, për realizimin e nje studimi me Bizneset kryesisht Bujqesore dhe vlerësimin e nevojave te tyre per kredi në Bashkine fier ;

- Ekspert Drejtues per Studimin (1 Ekspert)

Fondi limit është **910,000** lekë

3.Data dhe vendi

Me kërkesë të organizatës, produktet dhe shërbimet do të dorëzohen në Qendren *Shqiptare per Popullsin dhe Zhvillimin* adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta, Nd.26, H.6, Ap5, 1001,Tiranë, Albania.

4. Profili i kërkuar i aplikantit

- Master Shkencor në Shkenca Sociale ose Juridike; preferohet të paktën 7 vjet experience e vërtetuar pune në fushën e Studimeve .
- Njohuri shumë të mira rreth situatës së dhe kuadrit ligjor per bizneset ne Shqiperi .
- Eksperiencë profesionale pune me organizatat e shoqërisë civile apo ishtitucione te tjera per realizimine Sherbimeve te ngjashme.
- Eksperiencë të mëparshme si lehtësues/e i takimeve përfshirëse me aktorë vendorë ose si trajner/e në fushën Ekomonise ose si ekspert në hartimin e politikave e studimeve ekomomise dhe Zhvillimit dhe në Bizneseve .
- Njohuri te Gjuhes Angleze dhe projekte te Bashkimit Europian.

5. Kontratat dhe Tarifat

Eskperti do të lidhë një kontratë shërbimi me organizatën. Pagesa do të kryhet në llogarinë bankare te ekspertit sipas kushteve te rena dakort ne kontrate dhe dorëzimit të produkteve dhe shërbimeve përkatëse.

Produktet dhe shërbimet orientuese janë:

1. Mbledhje informacioni nga studime, raporte te mëparshme, sondazhe dhe botime mbi aksesin ne financa te ndermarrjeve te vogla dhe te mesme(NVM) ne Shqiperi, te disponueshem ne internet dhe ne hard copy, si dhe konsultime telefonike dhe online me eksperte te bankave tregtare dhe te institucioneve te mikro-kredise, per draftimin e Pyetesorit per NVM-te ne qarkun e Fierit.

2. Takime me Kryetarin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë të qarkut Fier dhe ekspertet e Dhomes, si dhe me organizata te tjera dhe grupe interesi te NVM-ve ne qark, ne kuader dhe shpjegim te aktiviteteve dhe produkteve te Projektit “3C4SME”

3. Takime me eksperte per zhvillimin e qendrueshem te sektorit privat ne Prefekturën Fier dhe ne Bashkinë Fier, ne kuader dhe shpjegim te aktiviteteve dhe produkteve te Projektit “3C4SME”

4. Kampionim i NVM-ve per t’u intervistuar, ne baze te peshes specifike te kontributit te tyre ne prodhimin e pergjithshem te qarkut Fier (NVM prodhuese, ne agro-perpunim, ne prodhimin bujqesor, ne tregti, sherbime, turizem, etj.)

5. Biseda dhe takime me 20 kandidatë potencialë të NVM-ve për pjesëmarrje në Veprimin Pilot(Pilot Action), për të mbështetur pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet dhe produktet e Projektit;

6. Realizimi i Studimit dhe Raportit Perfundimtar.

7. Organizimi i një fushate të ndërgjegjësimit publik në mediat lokale dhe qendrore shqiptare, për të përcjellë mesazhet e nevojës kryesore për ndryshimin dhe përmirësimin e legjislacionit të aksesit të SME-ve në financa, sipas gjetjeve te rezultateve te pyetesorit, për të ndikuar tek ligjvënësit dhe për të rritur profilin e aktiviteteve të 3C4SME.

QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

Aplikimi

Ju ftojmë të shprehni interesin tuaj duke dërguar aplikimet tuaja brenda datës **25.02.2020, ora 16:30** me E-mail (info@acpd.org.al) me postë ose dorazi në adresën (adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta, Nd.26, H.6, Ap5, 1001,Tiranë, Albania, tel:

Çdo aplikim i marrë pas datës së mbylljes së procedures nuk do të pranohet.

Dokumentat e aplikantit si më poshtë:

- Cv
- Oferta Financiare në Vlerë Bruto (përfshire Taksat) për shërbimin që kërkohet.

Vlerësimi i ofertave:

Të gjithë ofruesit do të vlerësohen për plotësimin e dokumentacionit , eskperiences dhe oferten me te ulet financiare.

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH), inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.